



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 228, Datë 28.10.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “SLR ALBANIA” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2152/1 prot., datë 25.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “SLR ALBANIA” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “SLR ALBANIA” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2152 prot., datë 16.10.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmën “c”; për pikën 2.1 gërmat “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Rezulton se shoqëria “SLR ALBANIA” sh.p.k.:
 - Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Kontratën nr. 114 rep., nr. 73 kol., datë 31.01.2024 “Për ndërtimin, shfrytëzimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 MW, dhe veprave ndihmëse, në fshatin

Grukë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqërisë “SLR ALBANIA” sh.p.k.”.

- Ka marrë miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., nr. 5972/3 prot., datë 27.07.2022.
 - Është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më datë 28.07.2022 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “*Ndërtimi i impiantit fotovoltaik 2 MW, Topojë, Fier*”, për shoqërinë “SLR ALBANIA” sh.p.k. Kjo VNM ka qenë e vlefshme deri më datë 28.07.2024, ndaj shoqëria duhet të dokumentojë që ka filluar punimet e ndërtimit të centralit fotovoltaik brenda kësaj date, ose duhet të depozitojë një VNM të re.
- Nga ky aplikimi nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”**: Aplikuesi duhet të depozitojë të përditësuar vërtetimin për gjendjen gjyqësore për shoqërinë, i cili është lëshuar me datë 16.10.2024, më herët se 1 muaj nga paraqitja e aplikimit të shoqërisë në ERE dhe në zbatim të përcaktimeve të nenit 8, pikës 3 të Rregullores, vlerësohet që t’i kërkohet shoqërisë që të depozitojë vërtetimin për gjendjen gjyqësore për shoqërinë të përditësuar.
- **gërma “c”**: Struktura organizative duhet të depozitohet e nënshkruar dhe/ose vulosur.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “a”**: Aplikuesi duhet të depozitojë vërtetimin mbi shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve shëndetësore, ndaj për plotësimin e kërkesave të kësaj pike të Rregullores, subjekti duhet të depozitojë në ERE veçmas vërtetimin që nuk ka asnjë detyrim në lidhje shlyerjen e këtyre detyrimeve ose periudhën që i korrespondojnë detyrimet sipas përcaktimeve të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*” e ndryshuar.
- **gërma “b”**: Aplikuesi duhet të depozitojë vendimin e organeve drejtuese të shoqërisë për vënien në dispozicion të fondeve të saja për realizimin e projektit. Shoqëria ka dokumentuar se do ta financojë projektin përkatësisht në vlerën 80% me kredi bankare dhe 20% me fonde të veta, si dhe ka dokumentuar vlerën përkatëse për realizimin e vlerës totale të projektit, por në lidhje me financimin nga fondet e veta, ka depozituar vetëm konfirmimin e llogarisë, për këtë arsye kërkohet që shoqëria të depozitojë dhe vendimin e organeve drejtuese të saj për dedikimin e vlerës monetare të saj të vënë në dispozicion të zhvillimit të projektit.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

- **gërma “a”:** Aplikuesi duhet të bëjë saktësimin e njësive gjeneruese, pasi rezulton se kapaciteti total tejkalon kapacitetin e përcaktuar në kontratën me MIE-n dhe lejet që ka marrë shoqëria.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SLR ALBANIA” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovotlaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “SLR ALBANIA” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI